

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike jo kontestimore të propozuesit Sh. Zh. nga V. me përfaqësues të autorizuar av.Ruzhdi Maloku nga Vushtrria, ndaj kundërpropozueses Komuna e Vushtrrisë, lidhur me kërkesën zëvendësim i kontratës mbi shitblerjen e banesës, jashtë seance, me datën 29.09.2022, e mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET I TËRHEQUR propozimi i propozuesit Sh. Zh. nga V., ndaj kundërpropozueses Komuna e Vushtrrisë, lidhur me kërkesën zëvendësim i kontratës mbi shitblerjen e banesës

A r s y e t i m

Përfaqësuesi i propozuesit me datën 29.09.2022, në këtë gjykatë ka dorëzuar parashtrësë për tërheqje të propozimit të propozuesit me arsyetimin se është hyrë në fuqi Ligji nr.08/L-011, për blerjen e banesës dhe kërkesa e tij do të realizohet në procedurë administrative, pranë kundërpropozueses.

Andaj gjykata nga të lart cekurat e në mbështetje të nenit 12.1 të LPJK-së ku përcaktohet se: Propozimi me të cilin është inicuar procedura mund të tërhiqet derisa të jepet aktvendimi i shkallës së parë për zgjidhjen e çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CN.nr.01/21, datë: 29.09.2022

GJYQTARI

Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta në ankesë.